



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 400/01-11408, dt: 28 Shkurt 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Jeton (Rexhep) Bala, Edison (Rexhep) Bala dhe Ismet (Murat) Bala, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës, në takimin e mbajtur më datë: 28 Shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 04/2025

Mbi Miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Jeton (Rexhep) Bala, Edison (Rexhep) Bala dhe Ismet (Murat) Bala me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumëbardhit - shetitore dhe hapësirë e hapur publike si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumëbardhit - shetitore dhe hapësirë e hapur publike, si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcelat kadastrale nr.2261-4 në sipërfaqe prej 9m² ZK Pejë dhe nr.2261-8 në sipërfaqe prej 13m² ZK Pejë pronë e pronarëve Jeton (Rexhep) Bala me ½ dhe Edison (Rexhep) Bala me ½ si dhe parcelat kadastrale nr.2261-6 në sipërfaqe prej 7m² ZK Pejë dhe nr.2261-10 në sipërfaqe prej 13m² në pronësi të Ismet (Murat) Bala do të merren për nevoja të rregullimit të shtratit të Lumëbardhit si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jenë objekt këmbimi me ngastrat kadastrale nr.6191-2 me sipërfaqe prej 11m² ZK Pejë dhe nr.2257-10 me sipërfaqe prej 31m² ZK Pejë pronë **Komuna e Pejës**.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 06.02.2025.

-Prona e Komunës, ngastrat kadastrale nr.6191-2 në sipërfaqe prej 11m² ZK Pejë dhe nr.2257-10 në sipërfaqe 31 m² është vlerësuar 750.00 €/m²

-Prona private e pronarëve privat Jeton (Rexhep) Bala dhe Edison (Rexhep) Bala, ngastrat me numër 2261-4 në sipërfaqe prej 9m² ZK Pejë dhe 2261-8 në sipërfaqe prej 13m² ZK Pejë si dhe pronat private e Ismet (Murat) Bala ngastrat me numër 2261-6 në sipërfaqe prej 7m² ZK Pejë dhe 2261-10 në sipërfaqe prej 13m² ZK Pejë është vlerësuar 750.00 €/m²
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do të nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.

- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,

Kryetarit të Komunës,

DÇPJ,

Arkiv.



KRYETARI I KUVENDIT
Rexhep Kurtbogaj